



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 02.06.2025
Numër Protokolli: 4141/2025

A.nr.314/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.314/2025 të datës 14.02.2025 të parashtruar nga ankuesi F.K, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Istrefi-Arbër Istrefi, me seli në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*largim nga shërbimi civil*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet** Vendimi me numër protokolli 14-116/01-6020/25 të datës 13.01.2025, i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, ndërsa lënda kthehet ***në rishqyrtim*** dhe ***rivendosje*** të organi i njëjtë.
- II. Obligohet** Komisioni Disiplinor në Komunën e Prishtinës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi sikurse në **pikën I** të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi, F.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Prishtinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Istrefi, më datë 14.02.2024 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1024/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.314/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit numër protokolli 14-116/01-6020/25 të datës 13.01.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, përmes së cilit akt ankuesit është shqiptuar masa disiplinore “*Largim nga Shërbimi Civil*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 04.03.2025 ka përcjellë shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Tutje, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vepruar sipas kërkesës së Kryetares së Kolegjit të datës 31.05.2025, përmes Vendimit me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 2116/2025 të datës 28.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.314/2025, të parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1024/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.314/2025; Autorizimin e datës 30.01.2025; Akt emërimit 01-112-937 të datës 11.01.2013; Vendimin me numër protokolli 14-116/01-6020/25 të datës 13.01.2025; E-mailin e datës 19.08.2024; Dy (2) Raportet mjekësore të datës 14.08.2024; Dy (2) Raportet mjekësore të datës 30.08.2024; Shkresën e datës 14.08.2024; Shkresat e datës 14.08.2024; Shkresën e datës 19.08.2024; Informimin e datës 22.08.2024; Shkresën e datës 23.08.2024, 26.08.2024; Informimin e datës 26.08.2024; Shkresën e datës 28.08.2024, 30.08.2024, 04.09.2024, 05.09.2024, 09.09.2024; Informimin e datës 09.09.2024; Informimin e datës 09.09.2023; Shkresën e datës 13.09.2024; Dërgesën e lëndës në kompetencë të datës 16.09.2024; Shkresën e datës 23.09.2024; Informimin e datës 23.09.2024; Tri (3) Shkresat e datës 24.09.2024; Shkresën e datës 25.09.2024; Shkresën e datës 29.09.2024; Vendimin 01nr.119-89744 të datës 27.04.2015; Vendimin 01nr.119-175166 të datës 04.08.2015; Vendimin 01nr.119-258619 të datës 12.11.2015; Njoftimin me numër protokolli 14-016/01-16092/25 të datës 31.01.2025; Mirënjohjen e vitit 2016; Certifikatën e datës 28.06.2014; Certifikatën me Nr.24335/06 të datës 29.04.2015; Certifikatën me Nr.10227/15 të datës 08.10.2015; Certifikatën me Nr.10350/15 të datës 29.10.2015; Certifikatën e datës 18.04.2016; Certifikatën e datës 18-21.04.2016; Vërtetimin e datës 20.10.2021; Vërtetimin e datës 17.11.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.02.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 04.03.2025; Akt emërimit e Nr.01-112-937 të datës 01.12.2021; Konkursin me numër reference RN00007660 të datës 28.09.2021; E-mailin e datës 04.11.2024; Aktin përcjellës të datës 31.10.2024; Formularin e raportimit të shkëljes së supozuar disiplinore me numër protokolli 14-116/01-142225/24 të datës 30.10.2024; Vendimin me Nr.14-112/02-91153/24 të datës 15.07.2024; E-mailin e datës 13.12.2024; Vendimin e datës 12.12.2024; E-mailin e datës 13.12.2024; E-mailat e datës 12.12.2024, 09.12.2024, 05.12.2024, 12.12.2024, 19.12.2024; Vendimin me Nr.14-116/01-10612/24 të datës 18.01.2024; Akt emërimet dhe kualifikimet arsimore të anëtarëve të Komisionit Disiplinor; Procesverbalet e datës 09.12.2024; E-mailin e datës 27.01.2025; Procesverbalin e seancës për votim të datës 16.12.2024; Raportin e vijueshmërisë, për muajin Janar, Shkurt, Mars,

Prill, Maj 2024; E-mailin e datës 28.02.2025; E-mailin e datës 19.08.2024; Kërkesën për pushim të datës 23.12.2024; Formularët e vlerësimit të punës të ankuesit.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje, sepse*:
Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Aktit të emërimit me numër Nr.01-112-937 të datës 01.12.2021, është i punësuar në pozitën e punës “*Udhëheqës i Sektorit për Planifikim Strategjik*” në Drejtorinë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm pranë Komunës së Prishtinës.

Tutje nga shkresat e lëndës, rrjedhë se Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, më datë 30.10.2024 ka parashtruar kërkesën me numër protokolli 14-116/01-142229/24, për inicimin e procedurës disiplinore ndaj tij për shkak të mungesave në punë në mënyrë të vazhdueshme pa aprovim paraprak që si rrjedhojë kanë shkaktuar edhe ngecje në realizimin e objektivave.

Ndërsa Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit, me Vendimin numër protokolli 14-116/01-6020/25 të datës 13.01.2025 ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuara sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.10 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, duke i shqiptuar masën disiplinore sipas nenit 57 paragrafit 2 nën paragrafit 2.7 të këtij ligji “*Largim nga Shërbimi Civil*”, për shkak të braktisjes së punës ose mungesave të paarsyeshme dhe të vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune, mos respektim në vazhdimësi të orarit të punës për më shumë se 3 ditë, duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm në mbarëvajtjen e objektivave të Drejtorisë përkatëse dhe duke neglizhuar detyrat e tij si Udhëheqës Sektori që mund të kenë shkaktuar dëme edhe ndaj Komunës së Prishtinës.

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi kontestues është nxjerrë përmes konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative, duke theksuar ndër të tjera se asnjëherë nuk i është shqiptuar masë disiplinore përkundrazi është nëpunës i dalluar i Komunës së Prishtinës, duke theksuar po ashtu se organi i punësimit i ka ndaluar qasjen në e-mailin e tij zyrtar andaj edhe nuk mundur ti siguroj provat tjera. Si rrjedhojë i njëjti kërkon të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të shfuqizohet vendimi i Komisionit Disiplinor, ashtu që të obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës që ankuesin ta kthej në vendin e tij të punës më të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas Akt emërimit të datë 01.12.2021 si dhe t’i bëjë kompensimin retroaktiv të të gjitha pagave prej momentit të largimit deri në ditën e kthimit në vendin e tij të punës.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të parashtruara në ankesë si dhe në ndërlidhje me shkresat e bashkangjitura të lëndës, i ‘u referuar dispozitave ligjore që rregullojnë disiplinën në Shërbimin Civil, përkatësisht:

-Nenit 55 i cili përcakton se: *1. Nën punësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim;*

-Nenit 56, paragrafi 1 dhe paragrafi 4 nën paragrafi 4.10, ku përcaktohet se: *1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda.; 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil;*

-Nenit 59, ku përcaktohet se: *1. Procedura disiplinore fillon mbi bazën e dyshimit të bazuar për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil, duke mos përjashtuar informatat e pranuar në mënyrë anonime. 2. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore për shkeljen e detyrave dhe përgjegjësi të punës nga nëpunësja/i civil. 3. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 3.1. me kërkesë të mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë të nëpunëses/it civil; 3.2. bazuar në të gjeturat dhe/apo rekomandimet e çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtareje/i tjetër brenda institucionit, si dhe me kërkesën e qytetares/it;.....si dhe*

-Nenit 61, paragrafin 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Për përcaktimin e masës disiplinore mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 62 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunëses/it për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore shqiptohen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.*

Rrjedhimisht, bazuar në kuadrin ligjor si me sipër, Kolegji analizoi aktin e kundërshtuar me ankesë, gjegjësisht Vendimin numër protokolli 14-116/01-6020/25 të datës 13.01.2025, me të cilin ankuesin Komisioni Disiplinor e ka shpallur përgjegjës për shkak të braktisjes së punës ose mungesave të paarsyeshme dhe të vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune, mos respektim në vazhdimësi të orarit të punës për më shumë se 3 ditë, duke i shqiptuar masën më të rëndë disiplinore “*Largim nga Shërbimi Civil*”, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstatoi se i njëjti vendim është i përfshirë në mos konstatim të plotë të gjendjes faktike, ngase me rastin e shpalljes përgjegjës të ankuesit nuk i ka përcaktuar apo konstatuar saktësisht ditët në të cilat ankuesi ka munguar nga puna, ngase duke marrë parasysh se disa prej tyre mund të jenë ditë vikendi apo festave zyrtare, i njëjti duhej të konstatonte saktësisht datat e mungesave të ankuesit nga vendi i punës dhe se po ashtu se Komisioni Disiplinor ka dështuar të konstatoj lidhjen shkakore mes veprimit të ankuesit dhe dëmit të shkaktuar apo thënë më

konkretisht se për cilat nga detyrat apo objektivat e punës i njëjti me këtë rast i ka shkaktuar dëme serioze organit përkatës të punësimit, ndër të tjera nuk ka marrë parasysh se ankuesit asnjëherë nga mbikëqyrësi i tij nuk i është tërhequr vërejtja apo nuk i është shqiptuar të njëjtit asnjë vërejtje me shkrim, qoftë për shkeljet e supozuara apo për mos përmbushje të detyrave të punës, si rrjedhojë akti i kontestuar për nga përmbajtja dhe arsyetimi nuk ka mbështetje në dispozitat e nenit 48 paragrafit 1 nën paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ngase i njëjti nuk ka shpjeguar qartë situatën faktike, ashtu që i njëjti akt është në kundërshtim edhe me paragrafin 2 të këtij neni, i cili përcakton se: *“2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”* dhe si i tillë konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për rrjedhojë e njëjti është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, nga thëniet si në ankesë të ankuesit konstaton se institucioni punëdhënës, respektivisht Komuna e Prishtinës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 2 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërlidhur me nenin 144 paragraf 1 të të njëjtit ligj ku është përcaktuar në mënyrë taksative se kur një akt administrativ bëhet i ekzekutueshëm, respektivisht është përcaktuar se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës”* ngase në rrethanat e rastit konkret nuk është plotësuar asnjëri nga parakushtet ligjore që vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 13.01.2025, i cili tani në këtë procedurë është objekt shqyrtimit, të ekzekutohen, e për rrjedhojë ky veprim bie ndesh me dispozitat e nenit 2, nenit 8 paragrafi 2 dhe nenit 9 paragrafi 2 lidhur me pritshmëritë e ligjshme të palëve në procedurë dhe parimin e administratës së hapur sikurse përcaktohet me dispozitat e LPPA-së, rrethanë kjo e cila ka ndikuar që ankuesi të jetë në situatë jo të barabartë si palë në procedurë, respektivisht fakti që ankuesit menjëherë i është konfirmuar masa, apo i është bllokuar çasja në pajisjet e punës dhe i është pamundësuar dalja në punë, e që të gjitha këto janë veprime që e kanë rënduar situatën juridike në dëm të ankuesit.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marrë për bazë së respektimi i dispozitave procedurale është njeri ndër parakushtet kryesore për nxjerrjen e një akti administrativ të drejt dhe të ligjshëm, dhe meqenëse, me provat e administruara është vërtetuar se në rrethanat e rastit konkret, akti i kontestuar me ankesë është nxjerrë përmes shkeljes së dispozitave procedurale, Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj Vendimin me numër protokolli 14-116/01-6020/25 të datës 13.01.2025 të Komisionit Disiplinor, dhe çështjen të kthej në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, ri procedurë të veproj sipas pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, duke eliminuar fillimisht shkeljet e konstatuara procedurale dhe materiale në kuptim që të konstatohet se vendimit përfundimtar për përfundimin nga marrëdhënia e punës i ka parapri ndonjë masë disiplinore ndaj ankuesit për shkeljet e supozuara, dhe pas konstatimit në mënyrë të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të nxjerr vendim meritator në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.314/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokaturës Istrefi-Arbër Istrefit;
- Komunës së Prishtinës (Komisionit Disiplinor dhe Menaxherit të Burimeve Njerëzore); si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.